



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec



Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No. (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No. 01/10 Nr. ifaq. Br. nr./No. pg. 85

Data/Date/Date 24.03.2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 14 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

- JEPET PËLQIMI** paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, respektivisht objektin e hotelit "Park plaza" në Rahovec, personave fizikë dhe juridikë deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet, për ushtrimin e veprimtarisë biznesore, përmes procedurës së shprehjes së interesit.
- Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi është në zonën kadastrale Rahovec, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-09038-2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2793m² (dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre metra katror), duke përfshirë edhe objektin e hotelit "Park plaza", e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
- Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor të hotelierisë dhe të gastronomisë dhe t'u jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
- Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të jetë 2,000.00€ (dy mijë euro) në vit.
- Realizimi i pagesës së qirasë do të fillojë 24 (njëzet e katër) muaj pas nënshkrimit të kontratës në mes të qiradhënësit dhe të qiramarrësit.
- Prona e paluajtshme e cekur në pikën 2 të këtij vendimi nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i donjës barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
- Objektet përcjellëse dhe investimet e tjera në këtë pronë, pas mbarimit të afatit të dhënies në shfrytëzim të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do t'i kalojnë në pronësi Komunës së Rahovecit.

8. Parcela e cekur në pikën 1 të këtij vendimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 2023 – 2031, me nr. prot. 01 Nr. 182/24, të datës 30.1.2024, gjendet brenda zonës ndërtimore.
9. **OBLIGOHET** Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, të zhvillojë procedurat e konkurrimit të hapur përmes shprehjes së interesit, konform Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
10. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me nr. prot. 01 Nr. 31/25, i datës 28.3.2025, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr. 50/25, të datës 29.4.2025.
11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.120/26
Më datë:24.03.2026

